

## Akt-Themelimi

### I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

#### Autoport SHPK

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Autoport” SHPK, e përbërë nga:

1. **Dea SHIAJKU**, e bija e z. Ervin SHIAJKU dhe znj. Albana SHIJAKU, lindur më 15.10.2003 në Tiranë, Shqipëri dhe banues në adresën: Rruga Vildan Luarasi, Nd. 3, H.1, Njësia administrative nr.9, Njësia bashkiake nr. 9, 1016, Tiranë, me nr.personal K36015063F në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme **100 000** (njëqind mijë) Lekë që përbën **100%** të kapitalit të shoqërisë.

Në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit Shqiptar, vendosën të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “Autoport” SHPK mbi bazën e këtyre principeve:

#### Neni 1

##### Emri dhe Forma

- 1.1 Emri i shoqërisë është “Autoport” (Shoqëria), ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “SHPK”, i cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

#### Neni 2

##### Baza Ligjore

- 2.1 Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar si dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

#### Neni 3

##### Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Bashkia Tiranë, Rruga: Marikaj, Ndërtesa nr. 020**. Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo dhe brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.



#### Neni 4

#### Kohëzgjatja dhe Prishja e Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent.
- 4.2 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar.

#### Neni 5

#### Objekti i Veprimtarisë

##### 5.1 Shoqëria “Autoport” SHPK është:

-Shkarkim/ngarkim autoveturash, agjensi spedicionere dhe veprime doganore, transport kombëtar dhe ndërkombëtar autoveturash, magazinim dhe parkim autoveturash dhe kamionësh.

#### Neni 6

#### Kapitali Themeltar dhe ndarja e tij

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total **100 000** (njëqind mije) Lekë, i ndarë në 1 (nje) kuote me vlerë nominale **100 000** (njëqind mije) Lekë.
- 6.2 Pjesëmarrja me kuota e ortakeve është si më poshtë:

- **Dea SHIAJKU** zotëron **100%** të kuotave të shoqërisë.

#### Neni 7

#### Aktet e Shoqërisë

- 7.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 8

#### Organet Drejtuese

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi drejtues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 8.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorët e Shoqërisë “Autoport” SHPK”, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.
- 8.3 Administratori i shoqërisë **Znj. Dea SHIJAKU** është emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Në rast se në vijim do të emërohen administratorë të tjerë ata mund t’i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht ose veç e veç.



**Neni 9**  
**Dispozitat e Fundit**

- 9.1 Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.
- 9.2 Ky Akt-themelimi është hartuar me 2 (dy) ekzemplarë në gjuhën Shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, 15/04/2024

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**  
**“Autoport” SHPK**

Dea Shijaku

